



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eing Com shpk" të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eing Com shpk" të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Eing Com shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 05.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: Parashtruesi i kundërshton të gjitha arsyet eliminuese duke pretenduar se ato janë të pasakta dhe të pavërteta. Njëkohësisht pretendon se edhe tenderuesi i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për shkak të marrëveshjes për themelimin e GOE dhe specifikave teknike. Njëkohësisht pajtohet me eliminimin e ofertave tjera si të papërgjegjshme.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:**

-Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër katër(4) mungon Çertifikates e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore është dorëzuar vetëm nga prodhuesi.

-Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbush kërkesat sipas kriterit të DT-së ku :

-Materialet: ofron PVC (standard) dhe PU (opsional). Siç u vlerësua më parë, këto materiale PVC dhe PU nuk i përmbushin kërkesën e specifikuar për materialet PP dhe PE. Ky është një defekt i rëndësishëm, pasi PP dhe PE janë të njohura për qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin e tyre në kushte të ndryshme klimatike, duke ndihmuar në zgjatjen e jetëgjatësisë së sistemit.

- Lidhjet dhe Ventilat: ofron ASTM Z dhe ASTM Universal për lidhjet e tubave. Kjo është një mangësi e dukshme, pasi kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A. STORZ 110A është një standard ndërkombëtar dhe përdorimi i një lidhjeje tjetër mund të shkaktojë vështirësi në lidhjen e tubave me pajisje të tjera të përputhshme.

Pikat Mbushëse: Nuk ka informacion të detajuar për mundësinë e lidhjes së pikës mbushëse në një pikë të vetme.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Pra oferta e tenderuesit të rekomanduar është oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të papabazuara në tërësi.

Vlen të shtohet fakti që lidhur me këtë aktivitet të prokurimit deri më tani ekzistojnë dy (2) vendime të OSHP (2025/0535 dhe 2025/0560). Sipas këtyre vendimeve të OSHP parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Pra të gjitha arsyet për eliminimin e ofertës së parashtruesit janë të sakta, të qëndrueshme dhe të konfirmuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 08.01.2026**

**Visar SHEHU**



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.